



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:221853

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05751220

Ac.nr.10057/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Naim Mehollli, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.Sh, të cilin e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” sh.p.k., kundër të paditurës Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga D.B, për kompensim dëmi jo material, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit dhe të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2191/13 e datës 21.05.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 29.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN ankesa e paditësit B.Sh dhe ankesa e të paditurës Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës dhe VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2191/13 e datës 21.05.2021.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin ankimor C.nr.2191/13 e datës 21.05.2021, ka vendosur si vijon:

I.APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesë padia e paditësit B.Sh, DETYROHET e paditura Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit jo material-vuajtjeve psikike për shkak të privimit të pa bazë nga liria dhe shkeljes së dinjitetit t’ia paguaj shumën në lartësi prej 1,800.00€ (një mijë e tetëqind euro) me kamatë vjetore e cila llogaritet si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 21.05.2021 në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

II. REFUZOHET pjesa e kërkesëpadisë së paditësit B.Sh përtej shumes së gjykuar në lartësi prej 59,200.00€ .

III.DETYROHET e paditura, Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 1,098.00€ në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i paditësit në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim si në ankesë.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim si në ankesë.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësi.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur e paditura.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesat e ndërgjyqësve janë të pa themelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, me datën 05.09.2013, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, për dëmshpërblim, kundër të paditurës Republika e Kosovës-Këshilli Gjyqësorë i Kosovës me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që gjykata ta detyroj të paditurën që paditësve t'ia paguaj dëmin jo material si në parashtrësën për precizimin e kërkesëpadsisë së datës 20/04/2021.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padsisë së paditësve pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e të njëjtit. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se me aktgjykimin P.nr.1786/12 të dt.25.10.2012 i Gjykatës Komunale në Prishtinë, i cili është bërë i formës së prerë me datë 18.12.2012, vërtetohet se paditësi B.Sh lidhur me veprën penale “*moslajmërim i veprës penale dhe kryesit nga neni 304 par.2 lidhur me nenin 1 të KKKP-së*”, është liruar nga aktakuza. Me këtë aktgjykim gjykata penale e ka vërtetuar pafajësinë e paditësit dhe rrjedhimisht është vërtetuar se qëndrimi i paditësit në paraburgim në kohëzgjatje prej 30 ditëve sipas Aktvendimit PPH.nr.306/08 i lëshuar nga Gjykata e Qarkut në procedurën paraprake kishte të bënte me privim të pa bazë të lirisë së paditësit. Gjykata vlerëson se si pasojë e privimit të kundërligjshëm nga liria, ku paditësi me asnjë veprim të tij nuk ka kontribuar në këtë situatë, atij i janë shkaktuar dëme të mëdha jo materiale, mbi frikën e përjetuar, degradim të personalitetit, dinjitetit, goditjes së rëndë ndaj nderit, të drejtave dhe lirive themelore njerëzore, të cilat kanë ndikuar me pasoja si në jetën familjare, profesionale dhe shume relacione tjera njerëzore dhe lartësia e aprovuar në emër të shpërblimit të dëmit jo material ndikon në zbutjen e pasojave negative dhe paraqet një satisfacion për të dëmtuarin, ndërsa pjesën tjetër të kërkesëpadsisë e ka refuzuar në mungesë të provave materiale. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar neneve 200 dhe 277 të LMD-së, nenin 7, nenin 319 të LPK-së.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 449, nenin 453 dhe nenin 463.1 dhe 2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i palës paditëse për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të paraparë me nenin 182 par.2 pika n) të LPK-së, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës as për këtë bazë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Gjykata i ka arsyetuar të gjitha rrethanat me peshë përcaktuese duke filluar nga përgjegjësia e të paditurit Këshilli Gjyqësor i Kosovës për kompensimin e dëmit, pastaj rrethanat që lidhen me kategorinë e dëmit dhe rrjedhimisht përfundimin për vëllimin e kërkesës së aprovuar. Gjendja faktike në këtë procedurë është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë edhe sa i përket pasojave që ka pësuar paditësi për shkak të privimit të tij nga liria. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë për vlerën provuese dhe besueshmërinë e ekspertizës së bërë nga lëmi i psikiatrisë nga dr.J.Z, në bazë të të cilës është konstatuar gjendja shpirtërore e paditësit si pasojë e privimit nga lira dhe dhimbjeve shpirtërore të pësuar nga ky shkak, i pranon si të tilla edhe Gjykata e Apelit, për të cilën ky është përfundim i drejtë dhe i pranueshëm. Andaj edhe për këtë bazë, sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike.

Gjykata e Apelit vlerëson se shumica e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë është adekuate me kriteret dhe qëllimin e përcaktuar me nenin 200 të LMD-së si dhe me udhëzuesin për caktimin e kriterëve orientuese dhe lartësisë së shpërblimit të drejt në të holla të dëmit jo material të lëshuar nga Gjykata Supreme e Kosovës Gj.A.nr.41/2023 e datës 27/02/2023, me të cilin udhëzim është paraparë shumica për një ditë të heqjes së lirisë prej 30 euro deri 60 euro, prandaj edhe Gjykata e Apelit e pranon në tërësi caktimin e lartësisë së kompensimit të dëmit dhe atë në shumës prej 60 euro për një ditë të heqjes së lirisë, për arsyes se rasti i arrestimit të paditësit ka marrë jehonë mediatike gjatë kohës së heqjes së lirisë, ngase në shkresat e lëndës rezulton se paditësi është arrestuar në vendin e tij të punës dhe është prangosur, ku i gjithë ky proces është përcjell nga mediat, ashtu që në shkresat e lëndës gjenden artikuj të ndryshëm të mediave vendor, ku e informojnë opinionin publik lidhur me arrestimin e paditësit dhe atë për veprat penale të rënda për të cilat dyshohej se i ka kryer gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare, prandaj kjo shumë përfaqëson

një satisfaksion adekuat që i dëmtuari (në këtë rast paditësi) t'i përballojë më lehtë dëmet jo materiale të pësuar, edhe pse këto forma të dëmit nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen me para. Me paragrafin 2 të nenit 200 të LMD përcaktohet se “me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të, të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”. Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e dhimbjeve shpirtërore të pësuar, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përballimin e tejkallimit të pasojave të dëmit që në këtë rast paditësi i ka pësuar si pasojë e privimit të kundërligjshëm të lirisë nga ana e insititucioneve gjyqësore të Republikës së Kosovës, në të njëjtën kohë ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfaksion të vërtetë për atë që është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Sipas nenit 5 par.5 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, i cili shprehimisht përcakton se “Çdo person që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim”. Të njëjtën të drejtë për kompensim këtu paditësit ia njeh edhe Protokollin 7 i Konventës së cekur më lartë, përkatësisht neni 3 i saj, i cili shprehimisht thotë: “Kur një person është dënuar për një veprë penale me vendim të formës së prerë dhe kur ky dënim është anuluar më vonë, ose në rast faljeje, për shkak të një fakti të ri ose të zbuluar rishtazi që provon një gabim gjyqësor, personi që ka pësuar ndëshkimin për arsye të këtij dënimi, zhdëmtohet sipas ligjit ose praktikës në fuqi në Shtetin në fjalë...”. Shumën e kërkuar përtej shumës së aprovuar, gjykata e shkallës së dytë i refuzoj si të pabazuar, ngase gjeti se e njëjta nuk përkon me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë procedurë, e as me natyrën dhe shkallën e të mirës së privuar të paditësit si pasojë e privimit të kundërligjshëm të lirisë së tij.

Edhe për kamatën gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe në pajtim me dispozitat e nenit 277 të LMD, duke e llogaritur atë prej ditës së marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë të datës 21.05.2021, e deri në pagesën definitive, me të cilin qëndrim pajtohet në plotëni edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat pretendime ishin të paqarta dhe nuk kishin të bëjnë me këtë çështje, dhe nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje më veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë se shpenzimeve dhe në pajtim me dispozita e LPK.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.10057/21, me datë 29.05.2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku